



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *42/T1-17* Prot.
Nr. Dok. 202503023/17

Tiranë *27/11* /2025

Lënda: Rekomandim përgjithsues lidhur me zbatimin korrekt të Ligjit Nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

IEVP 313 "JORDAN MISJA"

TIRANË

Për dijeni: MINISTRIA E DREJTËSISË

TIRANË

Të nderuar,

Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë, Z. Tedi Blushi¹, i është drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit me ankesë lidhur me kufizimin e takimeve dhe bisedave telefonike që janë vendosur ndaj Presidentit të Partisë së Lirisë, Z. Ilir Metaj, në IEVP "Jordan Misja", Tiranë.

1. PARASHTRIMI I RASTIT

Më konkretisht, në ankesë Z. Tedi Blushi shprehet se:

- "Në kundërshtim me Ligjin nr. 81/2020, pa njoftim dhe pa transparencë, administrata e IEVP "Jordan Misja" ka ndaluar, që prej datës 1 korrik 2025, që

¹ Ankesë e protokolluar në datën 09.07.2025.

Z. Ilir Metaj të kryejë biseda telefonike me të, megjithëse numri i tij është i regjistruar sipas parashikimeve ligjore.

- Edhe pse ka marrë leje të posaçme nga SPAK për të takuar Z. Metaj, kjo e drejtë i është mohuar disa herë nga administrata e institucionit.*
- Deputetë dhe eurodeputetë nuk janë lejuar të takohen me Z. Metaj, ndonëse ligji ua njeh këtë të drejtë, pa autorizim paraprak të prokurorit.*
- Nuk po zbatohet vendimi i datës 18.12.2024 i prokurorëve Z. Sotir Kllapi dhe Z. Arben Kraja, për t'i mundësuar Z. Metaj takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë së Lirisë, pa u llogaritur në numrin e takimeve familjare".*

Edhe përfaqësuesi ligjor i Presidentit të Partisë së Lirisë Z. Ilir Metaj, Av. Kujtim Cakrani, ka dërguar ankesë² drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për dijeni Avokatit të Popullit, ku në mënyrë të përmblodhur shprehet se:

"Prej datës 23 Tetor 2024, kur Z. Ilir Metaj është akomoduar pranë IEVP "Jordan Misja", Tiranë, ai po vuan një persekutim dhe inkuizicion të paprecedentë për faktin se:

- 1. Nuk lejohet të takojë fizikisht, por edhe as të komunikojë në telefon me anëtarët e Partisë së Lirisë;*
- 2. Nuk lejohet të takojë fizikisht deputetët e Partisë së Lirisë, gjithashtu as të komunikojë me telefon;*
- 3. Nuk lejohet të takojë dhe as të komunikojë me mediat dhe gazetarët dhe nuk ka asnjë kontakt me shtypin.*

I gjithë izolimi në mënyrë persekutimi dhe poshtëruese që ndiqet ndaj ish presidentit, ish kryeministrit dhe ish kryetarit të Kuvendit, justifikohet nga autoritetet se kështu është ligji dhe rregullorja e brendshme.

Është e vërtetë që Rregullorja e Burgjeve kufizon komunikimin për të paraburgosurit dhe të dënuarit, por këto kufizime janë të justifikuara nga siguria, rendi ose parandalimi i krimit. Kufizimet nuk mund të përdoren në mënyrë automatike për të ndaluar çdo kontakt politik, sepse kjo kthehet në një ndalim absolut dhe arbitrar.

Në një shtet të së drejtës:

- Kufizimet duhet të jenë proporcionale dhe të arsyetuara rast pas rasti.*

² Ankesë e protokolluar në datë 23.09.2025.

- Një lider partie nuk mund të ndalohet plotësisht nga komunikimi me partinë e tij, përndryshe kjo prek pluralizmin politik.
- Nëse kufizimet bazohen vetëm në rregullore pa analizuar të drejtën kushtetuese, atëherë ai është i paligjshëm dhe antikushtetues.

Ndërsa, për Z. Ilir Metaj nuk është provuar se ka arsye të forta sigurie për kufizimin e telefonatave, takimeve dhe kontaktit me mediat, duke cenuar kështu të drejtat dhe liritë kushtetuese të shprehjes, informimit dhe ushtrimit të funksioneve publike, të parashikuara në:

- *Nenet 17, 18, 22, 23, 45 dhe 48 të Kushtetutës së Shqipërisë.*
- *Nenet 10, 11, 18 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 3 të Protokollit nr.1 të Konventës”.*

Në mbështetje të këtyre ankesave, ka patur edhe deklarata në media nga përfaqësues të subjekteve politike, lidhur me trajtimin e Z. Ilir Metaj, ku është kërkuar prej tyre nisja e një hetimi nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit.

Pasi u njohëm me këtë çështje, institucioni i Avokatit të Popullit referuar nenit 13, paragrafi i parë, të Ligjit nr.8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”, vlerësoi se ankesat e sipërpërmendura përmbanin elemente për t’u pranuar për shqyrtim nga ana jonë.

Për shqyrtimin e ankesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë së Lirisë, Z. Tedi Blushi dhe përfaqësuesit ligjor të Presidentit të Partisë së Lirisë Z. Ilir Metaj, fillimisht institucioni ynë iu drejtua me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP “Jordan Misja”, me shkresat Nr.K2/T1-2 Prot., datë 10.07.2025; Nr.K2/T1-4 Prot., datë 24.07.2025; Nr.K2/T1-8 Prot., datë 04.08.2025; dhe Nr.K2/T1-12 Prot., datë 18.09.2025, ku në mënyrë të përmbledhur kemi kërkuar se:

- A janë marrë në shqyrtim ankesat e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë së Lirisë dhe a i është kthyer përgjigje sipas parashikimeve ligjore?
- A janë vendosur kufizime për numrat me të cilët mund të kryejë telefonata Z. Ilir Metaj dhe kush është arsyeja e këtyre kufizimeve?
- Sa takime ka kryer Z. Metaj nga data e pranimit në IEVP “Jordan Misja”, me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë së Lirisë, deputetë të kësaj partie dhe eurodeputetë?
- Nëse nuk janë lejuar deputetë dhe eurodeputetë të marrin takim me Z. Metaj, pa autorizimin e prokurorit, ku bazohet qëndrimi i institucionit tuaj?

- A është kufizuar numri i takimeve të Z. Metaj me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë së Lirisë? Nëse po, ku bazohet ky qëndrim?
- Sa biseda telefonike ka kryer Z. Ilir Metaj gjatë qëndrimit në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë?

Në përgjigje të kërkesave të institucionit të Avokatit të Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar informacione me shkresën Nr.10993/1 Prot., datë 24.07.2025 dhe shkresën Nr.12594/1 Prot., datë 19.09.2025, ndërsa IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, ka dërguar informacion me shkresën Nr. 5275/1 Prot., datë 04.08.2025.

Bazuar në informacionet e dërguara nga DPB-ja dhe IEVP “Jordan Misja”, rezulton se:

a) Për sa i përket kufizimit të telefonatave të Z. Ilir Metaj me Z. Tedi Blushi.

Në përgjigjen e saj, IEVP “Jordan Misja” shprehet se, nuk ka marrë një vendim specifik për ndalimin e të drejtës së komunikimit të të paraburgosurit Z. Ilir Metaj me Z. Tedi Blushi, por është ndërmarrë një “*masë e përkohshme kufizuese*” në kuadër të shqyrtimit të shkeljes disiplinore, lidhur me ngjarjen e datës 01.07.2025. Kjo masë është ndërmarrë në vijim të konstatimit se Z. Ilir Metaj ka realizuar komunikime të drejtpërdrejta me mediat në transmetim “live”, përmes numrave të regjistruar në sistem me përfaqësuesin e tij ligjor dhe me Z. Tedi Blushi, regjistruar në sistemin e telefonatave si mik i tij, me kërkesë të Z. Ilir Metaj. Sa më sipër ky veprim nuk përbën ndalim të përgjithshëm të të drejtës për komunikim telefonik me një person të caktuar, por paraqet një pezullim të përkohshëm dhe të arsyetuar të të drejtës për komunikim telefonik me një person të caktuar, në funksion të hetimit të një shkelje disiplinore.

Lidhur me këtë pezullim të përkohshëm të telefonatave, IEVP “Jordan Misja” i referohet nenit 8/2³ të Ligjit nr.81/2020, duke u shprehur se institucioni ka të drejtë të marrë masa të përkohshme për të parandaluar dhe verifikuar çdo rast të dyshuar që cenon rregullin, sigurinë ose përdorimin jo të duhur të të drejtave të parashikuara, pasi një ngjarje e tillë cenon funksionimin e IEVP-së, duke sjellë pasojat si më poshtë:

- *Vendos stafin në pozitë të vështirë për të justifikuar ngjarjen.*
- *Dëmton reputacionin profesional të punonjësve të sigurisë.*
- *Kompromenton sistemin e monitorimit të bisedave.*
- *Rrit barrën hetimore mbi institucionin për incidente të ngjashme.*
- *Rrezikon masën disiplinore ndaj stafit pa faj konkret.*
- *Krijon perceptimin se rregullorja nuk zbatohet njësoj për të gjithë.*
- *Përdoret politikisht kundër institucionit të vuajtjes së dënimit.*

³ “Të drejtat e të burgosurit, sipas këtij ligji, mund të kufizohen në minimumin e nevojshëm dhe vetëm në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm në rastet dhe sipas kriterëve të parashikuara në këtë ligj”.

- Krijohet perceptimi se sistemi i burgjeve është i dobët për kontrollin e komunikimeve.
- I jep sinjal të paraburgosurve të tjerë se mund të komunikojnë pa leje.
- Nxist precedentë ku të paraburgosurit përdorin persona të tretë për komunikime.

Për sa i takon numrit të telefonatave, për periudhën 26.10.2024 deri më 18.08.2025, Z. Ilir Metaj rezulton se **ka kryer 3005 telefonata**, me kohëzgjatje që varion nga minimumi 1 minutë deri në maksimum 34 minuta.

Në vijim të hetimit administrativ të këtij rasti, në datën 30.07.2025, Avokati i Populli i shoqëruar nga Komisioneri i MKPT dhe Komisioneri i Seksionit të Veçantë, zhvilluan një takim me Z. Ilir Metaj, në mjediset e IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, ku ai shprehu të njëjtat shqetësime të ngritura nga Z. Tedi Blushi dhe përfaqësuesi i tij ligjor. Takimi u zhvillua në dhomën e tij të qëndrimit, pa praninë e personave të tjerë. Në këtë takim jemi vënë në dijeni se ndaj Z. Ilir Metaj janë dhënë dy masa disiplinore si pasojë e komunikimit të tij me median, në datën 09.06.2025 dhe 01.07.2025. Po ashtu, Z. Ilir Metaj parashtroi se këto masa e kanë privuar atë nga takimet me përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, të forcës së tij politike, por edhe nga aktivitetet sportive, duke pretenduar për një izolim të qëllimshëm të tij. Ndërkohë, Z. Metaj merrte informacion për shtypin, pa kufizim nga jashtë, nëpërmjet TV që e kishte në dhomën e tij. Në përfundim të vizitës dhe takimit me Z. Ilir Metaj, u administrua i gjithë dokumentacioni që dispononte IEVP lidhur me masat disiplinore dhënë ndaj tij.

Referuar dokumentacionit, në **raport incidentin e datës 09.06.2025** të mbajtur nga punonjësit të policisë së shërbimit në sektorin ku është akomoduar Z. Ilir Metaj, rezulton se, në orën 20:22 Z. Metaj ka shfrytëzuar kontrollin mjekësor në infermieri për të kryer një telefonatë me Z. Tedi Blushi, megjithëse i është bërë thirrje që nuk lejohej, pasi ishte mbyllur orari i veprimeve. Gjithashtu, gjatë kohës së kryerjes së telefonatës me Z. Tedi Blushi, ky i fundit ndodhej në një studio televizive, të cilën Z. Ilir Metaj e ka shfrytëzuar për të komunikuar dhe zhvilluar edhe një intervistë me moderatoren e emisionit.

Për këtë ngjarje, në datën 11.06.2025 është mbledhur Komisioni Disiplinor i IEVP “Jordan Misja”, i cili ka vendosur të japë ndaj Z. Ilir Metaj masën 10 ditë përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta, me motivacionin “*Moszbatim i urdhrave të personelit të institucionit ose vonesa e pajustificuar në zbatimin e tyre*”. Ky vendim i është komunikuar Z. Metaj në datën 12.06.2025.

Edhe sipas **raport incidentit të datës 01.07.2025** të punonjësit të policisë së shërbimit në sektorin ku është akomoduar Z. Ilir Metaj, ky i fundit, nga ora 11:25 deri në orën 12:05 pasi ka kryer një telefonatë me avokatin mbrojtës⁴, rezulton se në mënyrë të përsëritur ai e ka shfrytëzuar telefonatën për të komunikuar me median, pa miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

⁴ Ndërkohë që Av. Kujtim Cakrani ndodhej për intervistë në një studio televizive.

Komisioni Disiplinor i IEVP “Jordan Misja”, është mbledhur në datën 02.07.2025, ku gjatë seancës dëgjimore, Z. Metaj ka kërkuar të mbrohet nga përfaqësuesi ligjor dhe për këtë arsye seanca e radhës është caktuar në datën 07.07.2025, por përfaqësuesi ligjor i Z. Metaj ka njoftuar me e-mail të datës 05.07.2025 se nuk do të paraqitet pranë Komisionit Disiplinor. Në përfundim të procedurës disiplinore, Komisioni Disiplinor ka konstatuar se, telefonata është kryer në kuadër të të drejtës për komunikim me mbrojtësin ligjor, por ajo është bërë publike në një televizion, në formën e një deklarate mediatike, një ngjarje kjo e përsëritur dhe abuzuese me të drejtën e bisedave telefonike.

Komisioni Disiplinor i IEVP “Jordan Misja” arsyeton si vijon: *Në interpretim të nenit 49, pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 81/2020, të paraburgosurit kanë të drejtë të komunikojnë me median me autorizimin dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, bazuar në kërkesën e motivuar si dhe me miratimin paraprak me shkrim të prokurorit. Gjatë deklaratës publike të Z. Ilir Metaj, ai ka diskutuar lidhur me çështjen penale të tij dhe elemente që prekin drejtpërdrejt hetimin e SPAK, duke përmendur emra konkretë të prokurorëve, institucioneve dhe individëve të tjerë me një profil publik dhe drejtues⁵. Kjo krijon një precedent të rrezikshëm për sigurinë dhe neutralitetin e hetimit penal si dhe mund të nxisë raste të tjera të ngjashme nga të paraburgosurit e tjerë. Deklaratat e Z. Ilir Metaj nuk janë bërë spontane, por kanë qenë të planifikuara. Në IEVP nuk është paraqitur asnjë kërkesë nga Z. Ilir Metaj apo përfaqësuesi i tij për t’u përfshirë në transmetim live në media. IEVP nuk synon të kufizojë të drejtën e fjalës dhe shprehjes së lirë, por synon vetëm respektimin e rregullave të brendshme dhe rendin në institucion.*

Për këto arsye, Komisioni Disiplinor i IEVP “Jordan Misja”, ka dhënë ndaj Z. Ilir Metaj masën 14 ditë përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta, me motivacionin “Moszbatim i urdhrave të personelit të institucionit ose vonesa e pajustificuar në zbatimin e tyre”. Ky vendim i është komunikuar Z. Metaj në datën 10.07.2025. Sipas shënimit në vendimin e Komisionit Disiplinor, Z. Metaj ka refuzuar të nënshkruajë për marrjen në dorëzim të një kopje të tij.

Nuk rezulton të jetë bërë ankim ndaj vendimeve të mësipërme.

Nisur nga kërkesa e përsëritur e Z. Tedi Blushi, për të verifikuar nëse masat kufizuese ndaj Z. Ilir Metaj ishin ende në fuqi, në datën 14.10.2025, ndihmëskomisioneri i ngarkuar me detyrën për shqyrtimin e këtij rasti, ka verifikuar në vend situatën dhe ka përditësuar informacionin mbi ndalimin e telefonatave dhe kufizimin e takimeve me Z. Tedi Blushi. Drejtues të IEVP “Jordan Misja” kanë informuar se **“këto masa vazhdojnë të jenë ende në fuqi dhe ndalimi i telefonatave të Z. Ilir Metaj me Z. Tedi Blushi, do të zgjasë deri në momentin e një vendimi të Komisionit Disiplinor”**, pasi të vlerësohet nëse Z. Ilir Metaj ka tendencë për të përsëritur përdorimin e telefonatës me Z. Tedi Blushi, për të komunikuar me median.

⁵ Avokatit të Popullit nuk iu vu në dispozicion ndonjë vendim apo kërkesë e prokurorëve në lidhje me këtë fakt.

b) Për sa i përket kufizimit të takimeve me deputetë dhe persona të tjerë.

Në datën 31.01.2025, Z. Vangjel Dule, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe Z. Alfred Beleri, Eurodeputet i Parlamentit Evropian, janë paraqitur pranë IEVP-së “Jordan Misja” për të kërkuar informacion mbi procedurën ligjore për zhvillimin e një takimi me Z. Ilir Metaj. Nga ana e stafit të IEVP “Jordan Misja”, deputetët janë sqaruar se, për takimin me Z. Ilir Metaj nevojitet **“miratim paraprak nga prokurori”**. Pas këtij sqarimi, deputetët nuk janë paraqitur më pranë institucionit.

Gjithashtu, në datë 21.02.2025, deputetët Znj. Erisa Xhixho dhe Z. Petrit Vasili kanë kërkuar takim me Z. Ilir Metaj. Edhe në këtë rast, stafi IEVP-së kanë sqaruar përsëri deputetët se, nevojitet **“miratimi i prokurorit të çështjes”** për zhvillimin e takimit.

Këtë qëndrim, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP Jordan Misja e bazojnë në nenin 51, pika 1, të Ligjit nr. 81/2020, ku ndër subjektet që kanë të drejtë të vizitojnë institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale pa autorizim përfshihen edhe deputetët, por kur bëhet fjalë për realizimin e takimeve me persona të paraburgosur, kërkohet miratim paraprak dhe i detyrueshëm nga prokurori i çështjes, për çdo rast konkret, parashikuar në nenin 49, pika 1 të Ligjit nr.81/2020 dhe në nenin 70, pika 6, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

c) Për sa i përket kufizimit të numrit të takimeve të Z. Tedi Blushi me Z. Ilir Metaj.

Kërkesa e Z. Tedi Blushi, për t’i mundësuar takime me Z. Ilir Metaj, duke mos i llogaritur takimet e tij në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të “Partia e Lirisë”, me takimet e të afërmeve dhe familjarëve, **nuk** është përmbushur nga ana e IEVP “Jordan Misja”, me arsyetimin se kjo kërkesë nuk gjen mbështetje në aktet ligjore dhe nënligjore.

Për rrjedhojë, çdo takim që zhvillohet me të paraburgosurin, pavarësisht se në çfarë cilësie paraqitet vizitori, familjar, funksionar apo i afërt personal, është konsideruar nga IEVP-ja si pjesë e numrit të kufizuar të takimeve që lejohet të zhvillohen sipas rregullit të përgjithshëm dhe brenda kuadrit të miratimeve përkatëse nga organi procedues.

Sipas informacionit të DPB-së, nga data e pranimit të Z. Ilir Metaj në IEVP Jordan Misja, në Tetor 2024 deri në Qershor 2025, ai ka realizuar 13 takime me Z. Tedi Blushi, që variojnë nga 1-4 takime në muaj. Pra, në muajin mars, prill dhe maj 2025, Z. Tedi Blushi ka realizuar takime me Z. Ilir Metaj, megjithëse është plotësuar numri minimal i katër takimeve që lejohet të kryejnë të burgosurit me familjarë/të afërm.

Ndërsa, për periudhën korrik 2025 – 14 tetor 2025, Z. Ilir Metaj **nuk** ka realizuar takime me Z. Tedi Blushi. Ndërkohë, numri i takimeve të Z. Ilir Metaj me avokatin

nuk ka qenë i kufizuar dhe nuk ka cenuar numrin minimal të garantuar të takimeve me familjen.

Po sipas informacionit të dhënë nga IEVP “Jordan Misja”, për periudhën tetor 2024 – 14 tetor 2025, Z. Ilir Metaj ka realizuar: 118 takime me përfaqësuesit ligjorë; 3 takime me noter; 49 takime me familjarët; 2 takime me persona jashtë rrethit familjar, në total 172 takime, ose 14 takime në muaj. Këtij numri duhet t’i shtojmë edhe 2 takime të Z. Metaj me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit.

2. BAZA LIGJORE DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Korniza ligjore që rregullon trajtimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar në Republikën e Shqipërisë përfshin Kushtetutën e RSH, Ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, aktet ndërkombëtare për këtë qëllim, si dhe aktet nënligjore përkatëse. Më konkretisht:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ);
- Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”;
- VKM Nr. 209, datë 06.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”;
- Rregullat Evropiane për Burgjet (2006)⁶;
- Udhëzuesi mbi Rregulloren Evropiane të Burgjeve, të hartuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2023⁷;
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat e Nelson Mandela)⁸;

- Kushtetuta e RSH

Neni 15/2

“Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”.

⁶ <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>

⁷ <https://edoc.coe.int/en/european-prison-reform/11595-guidance-document-on-the-european-prison-rules.html>

⁸ https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Nelson_Mandela_Rules-E-ebook.pdf

Neni 17

“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.

Neni 25

“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”.

Neni 28/5

“Çdo person, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij”.

Neni 30

“Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”.

- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 3 i Konventës, sanksionon se askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimeve, trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 6 i Konventës, njeh të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe prezumimin e pafajësisë për çdo person të akuzuar për një vepër penale, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Neni 7 i Konventës, sanksionon se askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që në momentin kur është kryer, nuk përbënte vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

Neni 8 i Konventës, njeh të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Neni 10 i Konventës, njeh lirinë e shprehjes, e cila u nënshtrohet kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Neni 11 i Konventës, njeh të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, të cilat nuk mund t'u nënshtrohen kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Neni 18 i Konventës, sanksionon se kufizimet e lejuara sipas kësaj Konvente ndaj të drejtave dhe lirive të sipërpërmendura nuk do të zbatohen për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat janë parashikuar.

- Praktika e GJEDNJ

Burgimi, si një masë që i heq lirinë një personi, sjell kufizime të natyrshme në jetën e tij private dhe familjare. Megjithatë, është pjesë thelbësore e së drejtës së një të burgosuri, respektimi i jetës familjare dhe autoritetet duhet t'i mundësojnë atij ruajtjen e kontakteve me familjen dhe botën e jashtme.

Një i burgosur nuk i humbet të drejtat e tij sipas Konventës vetëm për shkak të statusit të tij si i burgosur. Çdo ndërhyrje në të drejtat e Konventës, duhet të justifikohet brenda mundësisë dhe qëllimit të kufizimeve që ka vendosur Konventa.

Parimi kryesor ku mbështetet praktika e GJEDNJ-së, në lidhje me të drejtat e të burgosurve, është domosdoshmëria e trajtimit me dinjitet të të gjithë personave të privuar nga liria dhe parandalimi i sjelljeve ose trajtimit çnjerëzor, poshtërues apo degradues⁹.

Gjykata ka pranuar një masë kontrolli të kontakteve të të burgosurve me botën e jashtme dhe kjo nuk është në vetvete e papajtueshme me Konventën (Aliev kundër Ukrainës, 2003, § 187; Kyriacou Tsiakkourmas dhe të tjerë kundër Turqisë, 2015, § 303). Masa të tilla mund të përfshijnë kufizimet e vendosura në numrin e vizitave familjare, mbikëqyrjen mbi këto vizita dhe nëse justifikohet, nga natyra e veprës penale dhe karakteristikat specifike individuale të një të paraburgosuri, ai mund t'i nënshtrohet një regjimi të veçantë burgu ose rregullave të veçanta të vizitave (Hagyó kundër Hungarisë, 2013, § 84).

⁹ https://ks.echr.coe.int/documents/d/echr-ks_guide_prisoners_rights_eng

- **Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” dhe VKM Nr. 209, datë 06.04.2022 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”**

Legjislacioni i brendshëm për të burgosurit ka si qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues.

Në çdo rrethanë, autoritetet publike nuk mund t’i shmangen detyrimit për të zbatuar nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku ndalohet ushtrimi i torturës, dënimeve, trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese. Kjo e drejtë është e paderogueshme sipas parashikimit të nenit 15, pika 2 të Konventës.

Jetesa në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale duhet të përafrohet sa më shumë të jetë e mundur me jetën në komunitet dhe kufizimet duhet të zbatohen si përjashtim. Sipas legjislacionit të brendshëm¹⁰, të drejtat e të burgosurit, mund të kufizohen në minimumin e nevojshëm dhe vetëm në përmbushje të një qëllimi të ligjshëm në rastet dhe sipas kritereve të parashikuara në këtë ligj.

Sistemi i burgjeve, në ushtrimin e veprimtarisë, duhet të udhëhiqet nga parimi i lehtësimit të riintegritimit në shoqëri të personave, të cilëve u është hequr apo kufizuar liria¹¹.

Në këtë kontekst, çdo masë kufizuese ndaj Z. Ilir Metaj mund të merret vetëm mbi bazën e një vendimi të qartë, të bazuar në një dispozitë ligjore dhe të arsyetuar, të marrë nga autoriteti kompetent dhe të njoftuar personit të interesuar.

- Kontakti i të burgosurve me botën e jashtme, takimet e të burgosurve¹² dhe bisedat telefonike:

I burgosuri ka të drejtën e vizitës të **paktën** katër herë në muaj me anëtarët e familjes me kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë. Në rastin e të paraburgosurve merret miratimi paraprak me shkrim i prokurorit (neni 49/1 i Ligjit nr. 81/2020¹³). Ndërsa, Rregullorja

¹⁰ Neni 8, pika 2 e Ligjit nr.81/2020 dhe neni 2, pika 7 e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

¹¹ Neni 12, pika 1 e Ligjit nr.81/2020 dhe neni 1, i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

¹² “I burgosur” është çdo person i paraburgosur ose i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, që vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale” (neni 3, pika 2 e Ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”).

¹³ 1. I burgosuri ka të drejtën e vizitës të **paktën** katër herë në muaj me anëtarët e familjes me kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë. Kur organizimi i institucionit e lejon, i burgosuri mund të autorizohet të qëndrojë me familjarët përtej kufirit kohor të parashikuar. Vizitat zhvillohen në mjedise të veçanta nën mbikëqyrjen e personelit të institucionit, jo të dëgjimit, sipas rregullave të parashikuara në rregulloren e përgjithshme të burgjeve.

e Përgjithshme e Burgjeve, e ka zgjeruar rrethin e personave, me të cilët mund të marrë takim i burgosuri, duke përfshirë edhe persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes (neni 70/1)¹⁴. Aktualisht, zbatohet parashikimi i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, për këtë pikë.

I paraburgosuri ka të drejtën e vizitës me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes me miratimin paraprak me shkrim të prokurorit (neni 70/6 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve).

Në nenin 49, pika 5 të Ligjit nr. 81/2020, parashikohet se “*Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale mundëson takime konfidenciale të të burgosurve me personat e parashikuar sipas nenit 51 të këtij ligji: anëtarët e komisionit të ekzekutimit të vendimeve penale, komisionerët e krijuar me ligj të posaçëm, përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike të garantuar nga shteti, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të të drejtave të fëmijëve, grave, të rinjve, me të cilët Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi*”.

Personat e përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 4 të nenit 51, mund të vizitojnë IEVP-në pa autorizim.

Më konkretisht:

“1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mund të vizitohen pa autorizim nga: Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, zëvendëskryetari i Kuvendit, zëvendëskryeministri, ministri i Drejtësisë, kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, deputetët, zëvendësministri i Drejtësisë, Avokati i Popullit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e tij, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe zëvendësit e tij, Drejtori i Policisë së Burgjeve, drejtori dhe inspektorët e kontrollit të brendshëm të burgjeve, anëtarët e komisionit të ekzekutimit të vendimeve penale, gjyqtarët dhe prokurorët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, mbrojtësit e të burgosurve, si dhe oficerët e Policisë Gjyqësore të deleguar.

2. Personat që shoqërojnë subjektet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, nuk pajisen me autorizim në rastin e vizitave pranë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, por në çdo rast numri i tyre nuk duhet të jetë më shumë se dy.

3. Mbrojtësit e të burgosurit mund të shoqërohen vetëm nga kandidatët për avokat që kryejnë stazhin pranë tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë.

Në rastin e të paraburgosurve merret miratimi paraprak me shkrim i prokurorit.

¹⁴ 1. Të burgosurit kanë të drejtën e zhvillimit të vizitës të paktën 4 (katër) herë në muaj me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, me një kohëzgjatje të paktën 1 (një) orë. Kur organizimi i institucionit e lejon, i burgosuri mund të autorizohet të qëndrojë me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes përtej kufirit kohor të parashikuar.

4. Të drejtën të hyjnë pa autorizim në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale e kanë edhe përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare, në kuadër të angazhimeve të marra përsipër nga Republika e Shqipërisë, gjatë kryerjes së vizitave monitoruese.

5. Personat e autorizuar në urdhrin e inspektimit nga ministri i Drejtësisë, gëzojnë të drejtën të hyjnë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

6. Personat e tjerë, që nuk parashikohen në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, mund të hyjnë në institucion vetëm me autorizim të drejtorit të institucionit.

7. Personat e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, kanë të drejtë të ankohen pranë drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në rast refuzimi pa shkaqe të arsyeshme të dhënies së autorizimit nga drejtori i institucionit.

8. Rregullat e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe për përfaqësuesit e komuniteteve fetare”.

Sa i takon të drejtës për të kryer biseda telefonike, të burgosurit i lejohet 8 (tetë) herë në muaj biseda telefonike me anëtarët e familjes, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretët, me shpenzimet e tij. Bisedat telefonike zhvillohen nën mbikëqyrjen vizuale të personelit të institucionit. Drejtori i institucionit, me vendim të prokurorit ose gjykatës, kufizon të drejtën e të paraburgosurit ose të të dënuarit për biseda telefonike (nenit 49/9 i Ligjit nr. 81/2020 dhe neni 74/1/4 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve).

Gjithashtu, të burgosurit kanë të drejtë të komunikojnë me median, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe të arsyeshme që përligjin moslejimin e këtyre kontakteve të lidhura me: ruajtjen e sigurisë brenda institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, me integritetin e viktimave, të burgosurve të tjerë ose të personelit të institucionit (neni 49/3 i Ligjit nr. 81/2020).

- **Rregullore Evropiane e Burgjeve¹⁵ (miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 11 janar 2006)**

Pjesa II, Kontaktet me botën e jashtme, parashikohet se:

24.1 Të burgosurve duhet t'u lejohet të komunikojnë **sa më shpesh** të jetë e mundur me anë të letrave, telefonit ose formave të tjera të komunikimit me familjet e tyre, personat e tjerë dhe përfaqësuesit e organizatave të jashtme dhe të presin vizita nga këta persona.

24.2 Komunikimi dhe vizitat mund t'i nënshtrohen kufizimeve dhe monitorimit të nevojshëm për vazhdimin e hetimeve penale, ruajtjen e rendit, sigurisë dhe parandalimit të veprave penale dhe mbrojtjes së viktimave të krimit, por kufizime të

¹⁵ <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>

tilla, duke përfshirë kufizime specifike të urdhëruara nga një autoritet gjyqësor, duhet të lejojnë megjithatë një nivel minimal të pranueshëm të kontaktit.

24.3 Ligji kombëtar duhet të specifikojë organet dhe zyrtarët kombëtarë dhe ndërkombëtarë me të cilët komunikimi i të burgosurve nuk duhet të kufizohet.

...

24.11. Autoritetet e burgut duhet të sigurojnë që të burgosurit të jenë në gjendje të marrin pjesë në zgjedhje, referendume dhe në aspekte të tjera të jetës publike, për aq sa kjo e drejtë nuk kufizohet nga ligji kombëtar.

24.12. Të burgosurve duhet t'u lejohej të komunikojnë me median, përveç rasteve kur ka arsye bindëse për ta ndaluar këtë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë, në interes të publikut ose për të mbrojtur integritetin e viktimave, të burgosurve të tjerë ose të stafit.

Pjesa VII, të burgosurit e padënuar, kontaktet me botën e Jashtme, parashikohet se:

99. Përveçse kur ka një ndalim specifik për një periudhë të caktuar nga një autoritet gjyqësor në një rast individual, të burgosurit e padënuar:

a) duhet të presin vizita dhe të lejohen të komunikojnë me familjen dhe persona të tjerë, në të njëjtën mënyrë si të dënuarit;

b) mund të kryejnë vizita shtesë dhe të kenë akses shtesë në forma të tjera të komunikimit; dhe

c) të kenë akses në libra, gazeta dhe media të tjera lajmesh.

- **Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve, Rregullat e Nelson Mandela¹⁶ (Rezoluta 70/175 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, shtojcë, e miratuar më 17 dhjetor 2015)**

Kontakti me botën e jashtme:

Rregulli 58

1. Të burgosurit duhet të lejohen, nën mbikëqyrjen e nevojshme, të komunikojnë me familjen dhe miqtë e tyre në intervale të rregullta:

(a) Nëpërmjet korrespondencës me shkrim dhe duke përdorur, kur është e mundur, telekomunikacionin, mjete elektronike, dixhitale dhe të tjera; dhe

(b) Duke pritur vizita.

¹⁶ https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Nelson_Mandela_Rules-E-ebook.pdf

Pra, sipas Rregullës 58 të Rregullave të Mandela-s, personat e burgosur kanë të drejtë të komunikojnë rregullisht me familjarët dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë, në mënyrë që të ruajnë marrëdhëniet sociale dhe të mbrojnë interesat e tyre.

Çdo kufizim i kësaj të drejte duhet të jetë i nevojshëm dhe proporcional, duke respektuar dinjitetin dhe integritetin personal të personit të privuar nga liria.

3. KONSTATIMET

Pas marrjes së ankesës dhe shqyrtimit paraprak, institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer hetim administrativ në lidhje me pretendimet e paraqitura nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë së Lirisë, si dhe nga përfaqësuesi ligjor i Z. Ilir Metaj.

Hetimi administrativ është kryer nëpërmjet kërkesave zyrtare për informacion, verifikimeve në vend dhe analizës së dokumentacionit të administruar nga IEVP “Jordan Misja”.

Në përfundim të këtij hetimi ka rezultuar:

- Kufizimi i takimeve të të burgosurve në vetëm 4 takime në muaj, pa marrë parasysh rrethanat individuale të të burgosurve (p.sh. distanca e familjes, nevoja sociale, statusi shoqëror dhe publik, probleme shëndetësore, apo mungesa e kontakteve të tjera), përbën kufizim të tepruar të së drejtës për jetë familjare dhe të drejtës për t’u organizuar.
- Ndalimi i vizitave konfidenciale të të paraburgosurve me Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe Eurodeputetë, duke kërkuar miratimin paraprak të prokurorit, vjen në kundërshtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.
- Kufizimi i telefonatave nuk është kryer sipas kritereve të parashikuara në ligj.
- Janë vendosur pengesa të pambështetura në ligj për komunikimin e të burgosurve me median.

4. VLERËSIMI I INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT:

Nga shqyrtimi i fakteve dhe dokumentacionit të mbledhur, Avokati i Popullit vlerëson se kufizimet e vendosura ndaj Z. Ilir Metaj nuk janë në përputhje me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe transparencës. Konkretisht:

- Për sa i përket numrit të vizitave të lejuara për një të burgosur:

Legjislacioni ka parashikuar një minimum të garantuar takimesh mujore, të të burgosurit me familjarët ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, por ky minimum takimesh nuk duhet të kthehet në një standard të ngurtë, i zbatueshëm për çdo IEVP dhe në çdo rast. Nuk gjen mbështetje në ligj, interpretimi se termi “të paktën

4 takime në muaj” do të thotë 4 takime në muaj, e mbi 4 nuk lejohet. Ky interpretim është qartazi alogjik dhe i kundërt me vetë ligjin, por edhe me standardet ndërkombëtare.

Si rregull, të paraburgosurit duhet të kenë një regjim më të lirë e më të gjerë për gëzimin e të drejtave edhe për shkak të aplikimit të parimit të prezumimit të pafajësisë¹⁷.

E drejta për jetë private dhe familjare është një e drejtë themelore njerëzore, jo vetëm për të burgosurit, por edhe për anëtarët e familjes së tyre. Të paraburgosurit kanë të njëjtën të drejtë për të kontaktuar me botën e jashtme si edhe të dënuarit, përveçse kur ka një ndalim specifik. Regjimi për të paraburgosurit nuk duhet të ndikohet nga mundësia e dënimit të tyre për një vepër penale, në të ardhmen.

Kontakti me botën e jashtme ofron një mbrojtje të rëndësishme kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, lehtëson rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm shoqëror, mbështet shëndetin psikologjik dhe mirëqenien e përgjithshme dhe mund të zvogëlojë rrezikun e vetëvrasjes dhe vetëlëndimit.

Legjislacioni i brendshëm dhe Rregulloria Evropiane e Burgjeve, u vendos autoriteteve të burgut një detyrë pozitive për të lehtësuar format e ndryshme të komunikimit për të gjithë të burgosurit në mënyrë që ata të mund të mbajnë kontakt me familjen dhe të tjerët. Rrethi i personave jashtë familjes, duhet të interpretohet sa më gjerësisht të jetë i mundur, duke përfshirë çdo person, me të cilin një i burgosur pranon të marrë takim, në varësi të kërkesave të sigurisë dhe mbrojtjes. Kjo është e rëndësishme për të lehtësuar mundësitë maksimale për kontakt me botën e jashtme, në mënyrë që të gjithë të burgosurit, përfshirë ata që nuk kanë marrëdhënie familjare të formalizuara, të mund të ruajnë mbështetjen nga jashtë burgut. Kontakti me botën e jashtme mund të përfshijë edhe përfaqësuesit e medias.

Vizitat janë një formë e rëndësishme e kontaktit, e cila duhet të ketë përparësi sa herë që është e mundur. Këto vizita barazpeshojnë ndikimin negativ të jetës në burg, dhe gjithashtu lehtësojnë një kalim më të butë nga burgu në komunitet duke siguruar një shkallë normaliteti dhe vazhdimësie.

Kufizimet, edhe nëse vendosen, duhet të bëhen vetëm në përputhje me parimet e ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Vendosja e kufizimeve duhet të mbështetet në vlerësime individuale të rrezikut dhe arsyet duhet të dokumentohen dhe shpjegohen qartë për ata që preken. Edhe në kushtet e kufizimit të takimeve, ajo duhet

¹⁷ Kushtetuta

Neni 30

Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë

Kodi i Procedurës Penale

Neni 4/1

1.1 pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.

të jetë e argumentuar si dhe të jetë e përcaktuar koha e fillimit dhe mbarimit të këtij kufizimi.

Kufizimi i takimeve të të burgosurve në vetëm katër të tilla në muaj, me arsyetimin se ky është minimumi i përcaktuar në legjislacion, nuk i shërben synimit për rehabilitimin, për riintegrimin e të burgosurit në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Për këtë, Avokati i Popullit inkurajon takime sa më të shpeshta, të cilat mund të kufizohen vetëm për arsye kapaciteti e infrastrukture, nëse nuk ka arsye të tjera sigurie apo rreziku për veprime kriminale.

Në rastin e Presidentit të Partisë së Lirisë Z. Ilir Metaj, kemi të bëjmë me përfaqësues të një subjekti politik dhe takimet e tij me Z. Tedi Blushi, i cili mban funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë së Lirisë, janë për më tepër të miratuara me vendimet e datës 16.12.2024 dhe 21.02.2025 të prokurorëve Z. Sotir Kllapi dhe Z. Arben Kraja.

Rregullorja Evropiane e Burgjeve njeh të drejtën e të burgosurve për të marrë pjesë në zgjedhje, referendume dhe aspekte të tjera të jetës publike, përveçse kur kjo e drejtë kufizohet nga ligji kombëtar (Rregulli 24.11).

Në kreun III (Liritë dhe të drejtat politike) të Kushtetutës, neni 46, pika 1, parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm”*.

Po ashtu, neni 11 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut parashikon se: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij”*.

Partitë politike janë një formë e organizimit, thelbësore për funksionimin e duhur të demokracisë, duke dhënë një kontribut të pazëvendësueshëm në debatin politik, i cili është në thelb të konceptit të shoqërisë demokratike. Funksionimi i tyre nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Kufizimi i takimeve të Presidentit të Partisë së Lirisë Z. Ilir Metaj, me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë së Lirisë Z. Tedi Blushi, për arsye se legjislacioni për të burgosurit përcakton një minimum vizitash, **përbën kufizim të pajustificuar në ligj të ushtrimit të të drejtës së organizimit.**

- Për sa i përket vizitave pa autorizim të disa subjekteve me të paraburgosurit:

Neni 51 i Ligjit nr. 81/2020, parashikon se disa zyrtarë dhe personat që mund t’i shoqërojnë ata, të listuar sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, mund të vizitojnë IEVP-të, pa autorizim dhe sipas nenit 49/5 të Ligjit nr. 81/2020, IEVP-ja duhet t’u mundësojë këtyre zyrtarëve, takime konfidenciale me të burgosurit.

Çmohet se ligjvënësi ka patur për qëllim që disa funksionarë të lartë, të kenë akses pa kufizime në burgjet e vendit, në mënyrë që të ushtrojnë pa vonesë dhe pengesë detyrën e tyre për të këqyrur nga afër kushtet ku mbahen të burgosur shtetasit dhe respektimin e të drejtave të tyre, për të cilat mund të jetë e nevojshme edhe marrja e takimeve me të burgosurit.

Miratimi me shkrim i prokurorit, i parashikuar në nenin 49/1 i Ligjit nr. 81/2020 dhe nenin 70/6 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, për të lejuar takimet e të paraburgosurit me anëtarët e familjes ose me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes (shokë e të afërm), ka të bëjë me të drejtën e të burgosurit për zhvillimin e vizitës të paktën 4 (katër) herë në muaj dhe jo me takimet me zyrtarë publikë, në kuadër të ushtrimit të detyrës së tyre.

Në listën e zyrtarëve publikë, të parashikuar në nenin 51, përfshihen edhe *Avokati i Popullit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e tij*. Nga ana jonë është marrë takim konfidencial me të paraburgosurit në kuadër të inspektimit të përgjithshëm të IEVP-së apo të hetimit administrativ të një rasti konkret, pa autorizimin e prokurorit. Gjithashtu, në këtë listë përfshihet edhe *Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, prokurorët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, mbrojtësit e të burgosurve, si dhe oficerët e Policisë Gjyqësore të deleguar*, për të cilët nuk mund të kërkohej miratim për takimin me të paraburgosurit, pasi janë vetë ata që hetojnë çështjen.

Për rrjedhojë, edhe deputetët e përfshirë në listën e nenit 51, mund të marrin takim me të paraburgosurit pa miratimin me shkrim të prokurorit.

Neni 51 synon të garantojë kontroll të jashtëm dhe të pavarur mbi institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, për të siguruar që të drejtat e të dënuarve dhe të paraburgosurve të mbrohen nga:

- trajtimi çnjerëzor apo degradues;
- izolimi informativ;
- dhe mungesa e kontaktit me botën e jashtme.

Prandaj, ligjvënësi ka dashur që takimet e subjekteve të renditura në nenin 51, të jenë të pavarura nga ndërhyrjet hetimore. Nëse hyrja në IEVP e këtyre subjekteve do të varej nga miratimi i prokurorit, funksioni i tyre mbikëqyrës dhe parandalues do të cenohej, duke shkelur parimin e ndarjes së pushteteve.

Neni 51 është vendosur në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga:

- Neni 3 dhe 8 i KEDNJ,
- Protokoli Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar¹⁸;

¹⁸ Ratifikuar me Ligjin Nr. 9094, date 03.07.2003.

- Rekomandimi Rec(2006)2-rev i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, drejtuar shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve¹⁹.

Këto instrumente ligjore kërkojnë që organet kombëtare dhe ndërkombëtare të monitorimit të kenë akses të lirë, të papenguar dhe pa autorizim paraprak në burgje.

Prokurori nuk ka kompetencë të kufizojë ose të autorizojë hyrjen e subjekteve që kanë rol kushtetues ose ndërkombëtar, në IEVP-të, për të mbikëqyrur respektimin e të drejtave të njeriut.

Prandaj, autorizimi i prokurorit nuk është kërkesë për këto subjekte, sepse ato nuk janë “vizitorë privatë”, por organe zyrtare të mbikëqyrjes publike.

Po ashtu, Udhëzuesi mbi Rregulloren Evropiane të Burgjeve²⁰, i hartuar nga Këshilli i Evropës, referon në pikën 24.3 të kësaj Rregulloreje, ku parashikohet se ligji kombëtar duhet të specifikojë disa organe dhe zyrtarë, për të cilët komunikimi me të burgosurit nuk duhet të kufizohet asnjëherë. Udhëzuesi këshillon se, në këtë kategori subjektesh duhet të përfshihen për shembull, disa institucione kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të monitorimit të paraburgimit, gjykatat kombëtare dhe GJEDNJ-ja.

Duke iu referuar këtyre normave, rezulton se moslejimi i deputetëve Znj. Erisa Xhixho dhe Z. Petrit Vasili, për të marrë takim me Z. Ilir Metaj, me arsyetimin se duhet të ishte dhënë miratimi i prokurorit, është i pa bazuar në ligj.

Nga analiza e mësipërme rezulton se subjektet e parashikuara në nenin 51 të Ligjit nr.81/2020, jo vetëm që kanë të drejtë të hynë në IEVP pa autorizim, por atyre nuk u kufizohet e drejta edhe për të marrë takim me të dënuarit dhe të paraburgosurit, pa autorizim dhe pa miratimin e prokurorit të çështjes.

- Për sa i përket bisedave telefonike të të burgosurit:

Në rastin e Z. Ilir Metaj, IEVP Jordan Misja parashtrohet se ka ndaluar përkohësisht, pa një vendim specifik me shkrim dhe pa përcaktuar afat, komunikimin me telefon me Z. Tedi Blushi, si një masë kufizuese në kuadër të shqyrtimit të shkeljes disiplinore, lidhur me ngjarjen e datës 01.07.2025. Kjo masë është ndërmarrë në vijim të konstatimit se Z. Ilir Metaj ka realizuar komunikime të drejtpërdrejta me mediat në transmetim “live”, përmes numrave të regjistruar në sistem me përfaqësuesin e tij ligjor dhe me Z. Tedi Blushi.

Telefonata e Z. Ilir Metaj me median është konsideruar si veprim që vjen në kundërshtim me nenin 49, pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 81/2020²¹. Sipas interpretimit të

¹⁹ <https://rm.coe.int/09000016809ee581>

Pika 24.3. Ligji kombëtar duhet të specifikojë organet dhe zyrtarët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me të cilët komunikimi i të burgosurve nuk duhet të kufizohet.

²⁰ <https://edoc.coe.int/en/european-prison-reform/11595-guidance-document-on-the-european-prison-rules.html>

²¹ 3. Të burgosurit kanë të drejtë të komunikojnë me median, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe të arsyeshme që përlligjin moslejimin e këtyre kontakteve të lidhura me: ruajtjen e sigurisë brenda institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, me integritetin e viktimave, të burgosurve të tjerë ose të personelit të institucionit.

Komisionit Disiplinor të IEVP “Jordan Misja”, të këtyre neneve, të paraburgosurit kanë të drejtë të komunikojnë me median me autorizimin dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, bazuar në kërkesën e motivuar si dhe me miratimin paraprak me shkrim të prokurorit. Ndërsa, në IEVP nuk është paraqitur asnjë kërkesë nga Z. Ilir Metaj apo përfaqësuesi i tij për t’u përfshirë në transmetim live në media. Gjithashtu, deklarata në media e Z. Ilir Metaj, është konsideruar se prek drejtpërdrejt hetimin e SPAK, duke përmendur emra konkretë të prokurorëve, institucioneve dhe individëve të tjerë me një profil publik dhe drejtues. Sipas Komisionit Disiplinor, kjo krijon një precedent të rrezikshëm për sigurinë dhe neutralitetin e hetimit penal si dhe mund të nxisë raste të tjera të ngjashme nga të paraburgosurit e tjerë.

Çmojmë se ky interpretim i Komisionit Disiplinor të IEVP Jordan Misja, është i gabuar, pasi miratimi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe i prokurorit, duhet të merret kur një media kërkon të hyjë në mjediset e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale (neni 49/4 i Ligjit nr. 81/2020). Ndërsa, komunikimi i të burgosurit me median, ndalohet vetëm në rastet kur ka shkaqe të arsyeshme që përligjin moslejimin e këtyre kontakteve të lidhura me: ruajtjen e sigurisë brenda institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, me integritetin e viktimave, të burgosurve të tjerë ose të personelit të institucionit (neni 49/3 i Ligjit nr. 81/2020). Kjo dispozitë e Ligjit të brendshëm, është në harmoni me pikën 24.12²² të Rregullores Evropiane të Burgjeve, ku si rregull lejohet komunikimi i të burgosurve me median. Sipas shpjegimit të dhënë në pikën V të Relacionit të Projektligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, Rregullorja Evropiane e Burgjeve ka shërbyer si referim për hartimin e këtij projektligji, për të përshtatur objektivat e politikave kombëtare në drejtim të politikave evropiane.

E drejta e të paraburgosurit ose e të dënuarit për biseda telefonike mund të kufizohet nga drejtori i institucionit vetëm në raste specifike. Konkretisht, neni 49/9²³ i Ligjit nr. 81/2020 dhe neni 74/4²⁴ i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, e kufizon këtë të drejtë vetëm pas urdhrit të prokurorit dhe/ose gjykatës.

Në rastin e Z. Ilir Metaj, kufizimi i bisedave telefonike me Z. Tedi Blushi është bërë pa vendim të prokurorit apo gjykatës dhe pa një vendim të formalizuar të drejtorit të IEVP-së. Po ashtu, edhe nëse do të konsiderojmë të drejtë qëndrimin e IEVP-së, se

4. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, bazuar në kërkesën e motivuar, autorizon hyrjen e medieve në mjediset e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për autorizim mbahen parasysh të gjitha aspektet e sigurisë të parashikuara në pikën 3 të këtij neni. Në rastin e të paraburgosurve, merret miratimi paraprak me shkrim i prokurorit.

²² 24.12. Të burgosurve duhet t’u lejohet të komunikojnë me median, përveç rasteve kur ka arsye bindëse për ta ndaluar këtë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë, në interes të publikut ose për të mbrojtur integritetin e viktimave, të burgosurve të tjerë ose të stafit.

²³ 9. Të burgosurit i lejohet kryerja e bisedave telefonike me anëtarët e familjes, të afërmit dhe në raste të veçanta me të tretët. Bisedat telefonike zhvillohen nën mbikëqyrjen vizuale të personelit të institucionit. Drejtori i institucionit, me vendim të prokurorit ose gjykatës, kufizon të drejtën e të paraburgosurit ose të të dënuarit për biseda telefonike.

²⁴ 4. Drejtori i institucionit, me vendim të prokurorit ose gjykatës, kufizon të drejtën e të burgosurit për biseda telefonike.

komunikimi me median përbën shkelje të rregullores, përsëri ndalimi i komunikimit është në kundërshtim me ligjin, pasi jepen dy masa për të njëjtën shkelje. Në nenin 64, pika 2, të Ligjit nr.81/2020, ndalohet dënimi dy herë i të burgosurve për të njëjtën shkelje, për të cilën është shprehur më parë me vendim organi kompetent disiplinor. Kjo dispozitë është në harmoni me pikën 63²⁵ të Rregullores Evropiane të Burgjeve, ku gjithashtu ndalohet ndëshkimi i të burgosurit dy herë për të njëjtën sjellje.

Qëndrimi i mbajtur nga IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, se masa e ndalimit të telefonatave të Z. Ilir Metaj me Z. Tedi Blushi, do të shqyrtohet në një moment të dytë nga Komisioni Disiplinor, nuk gjen mbështetje ligjore, pasi Komisioni Disiplinor mbledhet me urdhër të drejtorit të institucionit, **jo më vonë se 48 orë** nga momenti i konstatimit të shkeljes²⁶, dhe kjo është një masë e shtuar përveç masës disiplinore *10 dhe 14 ditë përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta*, e cila nuk parashikohet si masë për shkeljet disiplinore²⁷. Po ashtu, kjo masë nuk parashikohet fare si masë disiplinore. Çdo Komision Disiplinor mund të marrë ato masa që përcakton ligji, sipas procedurës së parashikuar. Ndaj masave lejohet e drejta e ankimit.

Urdhri i dhënë për ndalimin e telefonatave të Z. Ilir Metaj me Z. Tedi Blushi, nuk ka marrë formë të shkruar, sikur edhe kërkohet në Kodin e Procedurës Administrative, për aktet administrative të organit publik.

Më konkretisht, referuar nenit 3, të Kodit të Procedurës Administrative, *“Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete”*.

Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ ka formë të shkruar në letër ose elektronike, verbale, ose çdo formë tjetër të përshtatshme. Organi publik është i detyruar të konfirmojë pa vonesë përmbajtjen e aktit verbal, në formë të shkruar në letër ose elektronike²⁸. Konfirmimi, në formë të shkruar, duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 99 të Kodit të Procedurës Administrative, ku përcaktohet përmbajtja e aktit administrativ.

Masat ndaluese për të burgosurit duhet të vendosen sipas një procedure që garanton elementët e një procesi të rregullt ligjor. Procedurat disiplinore dhe ndaluese, janë të

²⁵ Kapitulli Disiplina dhe ndëshkimi e Rregullores Evropiane të Burgjeve, pika 63: *“Një i burgosur nuk duhet të ndëshkohet dy herë për të njëjtin veprim ose sjellje”*.

²⁶ Neni 65, pika 4 e Ligjit nr. 81/2020 dhe neni 89, pika 2 e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.

²⁷ Ligji nr. 81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*

Neni 64

1. Për shkeljet disiplinore zbatohen këto masa:

a) këshillim individual;

b) përjashtim nga veprimtari të përbashkëta deri në 10 ditë;

c) përjashtim nga ajrosja në grup deri në 10 ditë;

ç) përjashtim nga veprimtaritë e përbashkëta deri në 14 ditë.

²⁸ Neni 98 i Kodit të Procedurës Administrative.

parashikuara për të kufizuar veprimin arbitrar të administratës së burgjeve në lidhje me personat e dënuar apo të paraburgosur.

Lidhur me pretendimin e përfaqësuesit ligjor të Z. Ilir Metaj, se ai po vuan një *“persekutim dhe inkuzicion të paprecedent”*, nga analiza e informacioneve, provave dhe fakteve të administruara nga ana jonë, rezulton se ato nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara.

Sikurse e shpjeguam edhe më lart, ndaj Z. Ilir Metaj janë vendosur disa kufizime, pas raporteve të incidentit mbi komunikimin e tij me mediat, të cilat pavarësisht se pretendohet se kanë karakter të përkohshëm, ato janë ende në fuqi dhe mbi të tëra janë të pabazuara në aktet ligjore dhe nënligjore

Po ashtu, në takimin e zhvilluar me Z. Metaj, u ngrit pretendimi se masat e sigurisë kanë ndikuar në kufizimin e aktiviteteve sportive që ai kryen në IEVP. Nga verifikimet tona rezulton se IEVP “Jordan Misja” ka hartuar një Plan-Masash të veçantë **për garantimin e sigurisë fizike dhe jetës** së Z. Ilir Metaj, gjatë daljes së tij në ajrim, pjesëmarrjes në aktivitetet social-kulturore, kryerjes së takimeve dhe trajtimit shëndetësor. Ky Plan-Masash është hartuar dhe miratuar që në momentin e akomodimit të Z. Metaj në IEVP dhe përditësohet në vijimësi. Në përfundim të analizës sonë të dokumentacionit dhe fakteve, rezulton se kufizimi i lëvizjeve gjatë aktiviteteve sportive, nuk është i ndikuar nga raportet e incidentit, por nga statusi publik dhe politik, për shkak të detyrave të larta shtetërore që ka ushtruar Z. Ilir Metaj, pasi në ambientet e IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, ndodhen edhe disa të paraburgosur me profil të lartë kriminal, ndaj lind nevoja e ruajtjes fizike dhe e jetës të Z. Ilir Metaj, përmes një plani të veçantë masash. Trajtimi i diversifikuar është i mundur dhe i parashikuar nga ligji²⁹.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti, shprehim gjithashtu qëndrimin e institucionit të Avokatit të Popullit se, përdorimi i lirisë së shprehjes duhet të bëhet në përputhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku njihet kufizimi i kësaj të drejte, nëse është e nevojshme në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Avokati i Popullit nuk promovon e as nuk amnistion përdorimin e gjuhës së urrejtjes, gjuhës të ashpër, fyese apo denigruese në media, pasi një gjuhë e tillë nuk gjen

²⁹ Neni 39/4 i Ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”:

“Vendosja e të burgosurit brenda institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet duke pasur parasysh mundësinë që ai të përfitojë nga një trajtim i diferencuar në grup, në përputhje me kërkesat dhe angazhimin e tij”.

mbështetje në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili garanton lirinë e shprehjes, por njëkohësisht imponon detyrimin për përdorimin e saj në mënyrë të përgjegjshme dhe në përputhje me etikën publike. Në këtë kuptim, çdo palë ka detyrimin institucional të shmangë çdo formë komunikimi publik që përmban gjuhë fyese, denigruese apo nxitëse të urrejtjes, sidomos në raport me organet e drejtësisë dhe institucionet publike, duke ruajtur integritetin dhe paanshmërinë e funksionit që ushtron.

Nga ana tjetër, e drejta e të dënuarve dhe të paraburgosurve për komunikim me median njihet dhe garantohet si pjesë e të drejtës për informim dhe shprehje. Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) masa e kufizimit të kësaj të drejte me urdhër të drejtorit të institucionit nuk mund të ketë karakter absolut, por duhet të jetë proporcionale, e arsyetuar. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, e drejta e të paraburgosurve dhe të burgosurve për të komunikuar me median njihet si rregull dhe kufizohet vetëm kur ka arsye bindëse dhe të individualizuara. Konkretisht, Rregulli 24.12 i *Rregullave Evropiane të Burgjeve*³⁰ parashikon se “*të burgosurve u lejohet të komunikojnë me median, përveçse kur ka arsye bindëse për ta ndaluar këtë në funksion të sigurisë/rendit, interesit publik ose mbrojtjes së viktimave, të burgosurve të tjerë apo stafit*”, ndërsa Rregulli 24 i tyre, në tërësi, e vendos kontaktin me botën e jashtme si parim themelor të trajtimit korrekt të personave të privuar nga liria. Në të njëjtën linjë, Rregullat “Nelson Mandela” të OKB-së (veçanërisht Rregulli 58 mbi kontaktet me botën e jashtme) kërkojnë lehtësimin e komunikimeve dhe lejojnë kufizime vetëm kur janë të domosdoshme dhe të ligjshme.

Në lidhje me të drejtën e personit të paraburgosur që ushtron funksionin e kryetarit të një partie politike, duhet konsideruar se, megjithëse i nënshtrohet rregullave të regjimit të paraburgimit, ai vijon të mbajë përgjegjësinë publike dhe funksionale që rrjedh nga pozita e tij politike.

Në parim, personi i paraburgosur ruan të gjitha të drejtat civile e politike që nuk janë në kundërshtim të domosdoshëm me vetë faktin e privimit nga liria; kjo rrjedh si nga Rregullat Evropiane të Burgjeve, të cilat vendosin marrëdhëniet me botën e jashtme si rregull dhe jo përjashtim (shih veçanërisht Rregullin 24 dhe standardin e komunikimit të lejuar me kufizime vetëm kur ka arsye bindëse e proporcionale), ashtu edhe nga rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi të drejtat elektorale, civile dhe sociale të të burgosurve, që nxisin respektimin e këtyre të drejtave sa herë që është e mundur brenda regjimit të sigurisë³¹.

Në këtë dritë, fakti që i paraburgosuri ushtron funksionin e kryetarit të një partie politike kërkon një ekuilibër specifik: autoritetet mund të parashikojnë leje dhe

³⁰ Rekomandimi Rec(2006)2-rev i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, drejtuar shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve.

³¹ Shih *Resolution (62) 2 (Adopted by the Ministers' Deputies on 1st February 1962) Electoral, civil and social rights of prisoners - Recommendation 195*
https://www.eodss.eu/template/default/compendium/Part%208/019_CoE_Recommendation_on_the_Electoral_Civil_and_Social_Rights_Prisoners_1962_EN.pdf

rregulla praktike, por nuk mund të vendosin ndalime absolute që i bëjnë të pamundura detyrat e funksionit, përveçse kur kufizimet janë të bazuara në ligj, të domosdoshme dhe proporcionale me një rrezik konkret. Ky standard përforcohet nga praktika e GJEDNJ që dënon përdorimin e masave të paraburgimit për synime jashtë atyre të parashikuara nga Konventa³². Në planin universal, Neni 25 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, siç interpretohet nga Komenti i Përgjithshëm nr. 25 i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, kërkon që kufizimet ndaj pjesëmarrjes në jetën publike të jenë të ligjshme dhe të nevojshme; fakti i paraburgimit nuk justifikon vetvetiu ndërprerjen e lidhjeve funksionale me partinë kur mund të menaxhohet me masa të arsyeshme sigurie³³. Një kryetar partie në paraburgim mund dhe duhet të ketë mundësi kontakti të kufizuar, të kontrolluar e të dokumentuar me anëtarësinë/strukturat drejtuese (përtej minimumit standard), në masën që kjo është e domosdoshme për ushtrimin e funksionit, pa u shndërruar në platformë fushate ose rrezik për rendin e sigurinë e institucionit.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

REKOMANDOJMË:

1. **Të rishqyrtohet menjëherë masa e kufizimit të komunikimeve telefonike dhe takimeve** ndaj Z. Ilir Metaj, duke vlerësuar nëse ajo është në përputhje me kriteret e proporcionalitetit dhe ligjshmërisë të përcaktuara në Ligjin nr. 81/2020.
2. Shuarjen e menjëhershëm të “masës së përkohshme” për ndalimin e komunikimit të Z. Ilir Metaj me Z. Tedi Blushi.
3. **Të garantohet e drejta për ankim** ndaj çdo mase kufizuese, duke informuar personin për mënyrën dhe afatet e ushtrimit të këtij mjete mbrojtjeje.
4. Të garantohet e drejta që të burgosurit të kryejnë më shumë se 4 (katër) vizita në muaj, kjo në varësi të dinamikës që paraqet çdo IEVP, veçanërisht në rastet kur të burgosurit kanë nevoja të veçanta familjare, publike ose sociale. Në çdo rast, IEVP-të të argumentojnë me shkrim mungesën e mundësisë për të lejuar më shumë se katër takime në muaj.

³² Shih çështjen **Demirtaş kundër Turqisë (nr. 2)**

[https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:{%22001-187961%22}}}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:{%22001-187961%22}})

³³ Shih CCPR General Comment No. 25: Article 25 (Participation in Public Affairs and the Right to Vote), The Right to Participate in Public Affairs, Voting Rights and the Right of Equal Access to Public Service <https://www.refworld.org/legal/general/hrc/1996/en/28176?>

5. Zbatimin me korrektësi të Ligjit nr. 81/2020, për të siguruar që subjektet e përcaktuara në nenin 51, pika 1 dhe 2, të kryejnë vizita në IEVP dhe takime konfidenciale me të paraburgosurit, pa miratimin e prokurorit.
6. Të sigurohet që bisedat telefonike të të burgosurve të kufizohen në zbatim të kriterëve të Ligjit Nr. 81/2020, vetëm me vendim të prokurorit ose gjykatës.
7. Të forcohen **mekanizmat e brendshëm të kontrollit administrativ** në sistemin e burgjeve në mënyrë që bisedat telefonike të të burgosurve të kufizohen vetëm në zbatim të kriterëve të Ligjit Nr. 81/2020 dhe Kodit të Procedurës Administrative, me një akt administrativ të shkruar dhe të arsyetuar, nga titullari i institucionit.
8. Marrjen e masave për të mos vendosur pengesa jo ligjore për komunikimin e të burgosurve me telefon me median, ku nuk kërkohet miratimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe i prokurorit.
9. Përgjithësimin e rastit për të përmirësuar procedurën në të tërë sistemin penitenciar, në zbatim të detyrimeve ndërkombëtare që Shqipëria ka marrë përsipër lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të personave të privuar nga liria.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit".

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Besnik DEDA



[Shqiptaria.com]

[Shqiptaria.com]

[Shqiptaria.com]

[Shqiptaria.com]

[Shqiptaria.com]

[S

[Shqiptaria.com]

[Shqiptaria